



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:253153
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05615489

C.nr.3926/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses RR.K nga GJ, Rr. "I.Q" nr..., kundër të paditurit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" - Fakulteti i Mjekësisë, me seli në Prishtinë, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga G.SH, me objekt kontesti anulimin e konkursit, pas mbajtës së seancës së shqyrtimit kryesor publik me dt.22.04.2024, në prezencën e paditëses, e në mungesë të palës së paditur, me dt.24.04.2024, mori dhe në të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses RR.K nga GJ, përmes së cilës ka kërkuar që të anulohet konkursi nr.1/173, i datës 27.04.2018 i Fakultetit të Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për pikat 13 dhe 50 të Konkursit, duke përfshirë të gjitha veprimet e ndërmarra me rastin e pranimit të kandidatit të sukseshëm, si dhe të detyrohet e paditura që brenda afateve të parapara të shpallë konkurs të ri për pozitën e mësimdhënëses në lëndët Mjekësia Interne, Propedutike e Mjekësisë Interne dhe Hyrje në Mjekësi në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësja RR.K nga GJ, fillimisht pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me dt.06.08.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" - Fakulteti i Mjekësisë, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimin e konkursit, lëndë kjo e cila është evidentuar nën shenjë Ac.nr.1938/18.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, përmes aktvendimit Ac.nr.1938/18, të dt.16.08.2018, është shpallur inkompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike, duke vendosur që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda së bashku me të gjitha shkresat t'i dërgohet Departamentit të Përgjithshëm të kësaj Gjykate.

Në referatin e padisë, paditësja ndër tjera ka theksuar se është Sub - Specialiste e Kardiologjisë - Interniste dhe aktualisht PhD kandidate në Universitetin KBC Zagreb në Kroaci dhe që nga viti 2004

e deri më tani ka pasur pretendime për të qenë pjesë e stafit të Fakultetit të Mjekësisë pranë Universitetit të Prishtinës, për çka në çdo konkurs të hapur ka aplikuar për lëndët të cilat burojnë nga drejtimi i saj i specializimit (kardiologji). Më tutje theksohet se me konkursin nr.1/173, të datës 27.04.2018 të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" - Fakulteti i Mjekësisë, ndër tjera është kërkuar edhe Profesor për lëndët Mjekësia Interne, Propedeutika e Mjekësisë Interne dhe Hyrje në Mjekësi, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe paditësja, duke shtuar se ka të përfunduar magjistraturën në drejtimin e kardiologjisë si dhe sub - specializimin në të njëjtin drejtim dhe njëkohësisht është në vitin e tretë dhe të fundit të studimeve të doktoraturës, ndërsa dokumentacionin i cili e dëshmon shkollimin ia ka bashkangjitur aplikacionit me rastin e konkurimit për pozitën e lartëcekur. Më tej pretendon se me rastin e shpalljes së rezultateve të kandidatëve lidhur me pozitën Profesor për lëndët Mjekësia Interne, Propedeutika e Mjekësisë Interne dhe Hyrje në Mjekësi, paditësja nuk ka qenë as në listën e ngushtë të kandidatëve. Ndaj listës përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm ka parashtruar ankesë me dt.14.06.2018 në Komisionin për Ankesa lidhur me emërimin e kandidatëve për zgjedhjen e stafit akademik, ndërsa Komisioni në fjalë, duke vepruar sipas ankesës, përmes raportit të shqyrtimit të ankesave të kandidatëve për konkursin nr.1/173, të dt.27.04.2018, e kishte refuzuar të njëjtën si të pa bazuar, me pretendimin se në pikën 50 të konkursit, në buletin nuk ka pasur të publikuar recension për këtë pozitë, ndërsa për pikën 13 të konkursit nuk i plotëson kriteret. Pretendimin se në buletin nuk ka pasur recension të publikuar për pikën 50 të konkursit, si dhe se nuk i plotëson kriteret për pikën 13 të konkursit, paditësja e konsideron të pa bazuar, me pretendimin se me provat të cilat do t'i bashkangjiten padisë vërtetohet një gjendje tjetër faktike. Tutje pretendon që Komisioni Vlerësues i kandidatëve si dhe Komisioni Shqyrtues për Ankesa nuk e ka vlerësuar faktin që në profesionin e mësimdhënës paditësja ka përvojë të gjatë pune, ku ka punuar në shkollën e mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" në Gjakovë, gjatë vitit shkollor 1998-1999. Pretendon që është bërë shkelje e rëndë e të drejtave të saj me rastin e vlerësimit të dokumentacionit mbi shkollimin dhe trajnimet e kryera, dokumentacion ky i cili i është bashkangjitur konkursit, duke pretenduar që nuk është marrë fare parasysh. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, në petitum të kërkesëpadisë ka propozuar që të anulohet konkursi nr.1/173, i datës 27.04.2018 i Fakultetit të Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për pikat 13 dhe 50 të Konkursit, duke përfshirë të gjitha veprimet e ndërmarra me rastin e pranimit të kandidatit të suksesshëm, si dhe të detyrohet e paditura që brenda afateve të parapara të shpallë konkurs të ri për pozitën e mësimdhënës në lëndët Mjekësia Interne, Propedeutike e Mjekësisë Interne dhe Hyrje në Mjekësi në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës.

Në seancë përgaditore, respektivisht shqyrtim kryesor, si dhe fjalë përfundimtare paditësja ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë thënieve në padi dhe kërkesëpadi, duke shtuar se ka aplikuar në konkursin kontestues të dt.27.04.2018, ndërsa me datë 09.07.2018 ka pranuar raportin për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve. Pretendon që përkundër faktit se i ka prezantuar punimet shkencore dhe ka mbajtur gradën shkencore "Magjistër i shkencave", në raport është evidentuar se e njëjta nuk ka doktoraturë e po ashtu nuk është evidentuar asnjë punim shkencor. Më tej ka theksuar se nuk janë evidentuar raportet e mentorëve të doktoraturës, ku ka qenë e regjistruar në Zagreb në vitin 2013 - 2014, si dhe punimet shkencore të vitit 2013 dhe 2016, si dhe fakti se ka qenë kandidate për PhD. Thekson që ka qenë specialiste e mjekësisë interne, sub - specialiste e kardiologjisë, e diplomuar në Zagreb e pastaj magjistre e shkencave nga viti 2011.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.3982/18, të dt.26.03.2019, në mbështetje të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurit, në

mënyrë që t'i ofrohet mundësia e paraqitjes së përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditësh, në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së. Nga shkresat e lëndës rezulton që i padituri aktvendimin e lartëcekur e ka pranuar në mënyrë të rregullt, mirëpo nuk ka parashtruar përgjigje në padi brenda afatit të paraparë ligjor.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.08.04.2024, pala e paditur, përmes përfaqësuesit të autorizuar ndër tjera ka deklaruar se konkursi ka qenë për staf të brendshëm, që parashihet edhe me Statutin e Universitetit të Prishtinës, ku çdo 4 vite stafi akademik i rregullt i nënshtrohet procedurës së konkursit për avancim apo për riemërim, nëse eventualisht nuk i posedon kriteret e nevojshme që kërkohen për avancim në thirrjen më të lartë akademike. Tutje ka pretenduar se përkundër bagazhit shkencor të palës paditëse, nuk ka pasur hapësirë ligjore dhe procedurale që e njejta të emërohet në pozitën e cila ka qenë e hapur në konkursin për të cilin bëhet fjalë, andaj në këtë kuptim e paditura e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë. Më tej ka pretenduar se kandidatja e emëruar në thirrjen akademike ku ka aplikuar më parë edhe paditësja i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara me dispozita ligjore që e përcaktojnë mënyrën e emërimit apo avancimit të anëtarëve të personelit akademik të Universitetit të Prishtinës, andaj ka lidhur marrëdhënie të rregullt të punës, është pajisur me vendim të senatit për emërim dhe vazhdon t'i kryejë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.22.04.2024, gjatë fazës së procedurës së të provuarit, ka administruar provat materiale si në vijim: Diploma e kualifikimit Universitar, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Mjekësisë, me dt.14.11.2005, nr.1187; Diploma e studimeve pasdiplomike, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Mjekësisë, me dt.22.08.2011, nr.237; Certifikata e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, nr.001772, e dt.24.04.2004; Raporti i shqyrtimit të ankesave të kandidatëve për konkursin nr.1/173, të datës 27.04.2018, i përpiluar me dt.28.07.2018; Ankesa me numër protokolli 6037, e dt.14.06.2018; Raporti i Komisionit Vlerësues për Emërim, Riemërim dhe Avancim të personelit akademik nr.4777/4 i dt.30.05.2018; Certifikata e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e Kroacisë, e datës 26.01.2009, me nr.534-07-2-2/2-09-4; Vërtetimi i lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare e Zagrebit, i datës 10.03.2009; Vërtetimi i lëshuar nga Fakulteti i Mjekësisë - Universiteti Trakya në Turqi me nr. B.30.2TRK0.20 i datës 20.11.2013; Abstrakti i zgjeruar nga Universiteti i Zagrebit Fakulteti i Mjekësisë i datës 03.10.2016.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" është hapur konkursi nr.1/173, i datës 27.04.2018, ku ndër tjera është kërkuar edhe "Profesor" për lëndët Mjekësia Interne, Propedeutika e Mjekësisë Interne dhe Hyrje në Mjekësi, siç nuk rezulton të jetë kontestues edhe fakti se paditësja ka qenë njëra nga kandidatet të cilat kanë aplikuar. Mbi këtë bazë, Gjykata nuk u thellua tutje në vërtetimin e fakteve të tilla në kuptim të dispozitës së nenit 321 par.2 të LPK-së, e cila përcakton që: *"Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor."*

Kontestues mes palëve ndërgjyqëse ngelet fakti nëse paditësja i ka përmbushur kriteret e kërkuara për tu emëruar në pozitën në të cilën ka aplikuar, gjegjësisht nëse konkursi i shpallur nga pala e paditur është i përfshirë me cenim të të drejtave nga marrëdhënia e punës për palën paditëse.

Nga diploma e kualifikimit Universitar, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Mjekësisë, me dt.14.11.2005, nr.1187, vërtetohet fakti se paditësja është regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në vitin akademik 1989-1990, ndërsa me datë 30.06.1998 i ka dhënë provimet e parapara për të mbaruar Fakultetin e Mjekësisë - Dega Mjekësi e Përgjithshme, me ç'rast ka marrë kualifikimin "Doktor i Mjekësisë", me notë mesatare gjatë studimeve 8.00.

Nga diploma e studimeve pasdiplomike, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Mjekësisë, me dt.22.08.2011, nr.237, vërtetohet fakti se paditësja është regjistruar në studimet pasdiplomike në vitin akademik 2001-2002, ndërsa me datë 27.06.2011 i ka kryer provimet e parapara për studimet pasdiplomike dhe e ka mbrojtur tezën e magjistraturës "Krahasimi i incidencës të stentit të trombozave te pacientët që kanë vendosur stentë me dhe medikament", me ç'rast ka marrë gradën "Magjistër i Shkencave të Mjekësisë".

Nga certifikata e lëshuar nga Qeveria e Kosovës - Ministria e Shëndetësisë, nr.001772, e dt.24.03.2004, vërtetohet fakti se paditësja me dt.23.03.2004 i është nënshtruar provimit specialistik nga lëmia "Mjekësia Interne" dhe sipas vlerësimit të komisionit e ka marrë titullin e mjekut specialist nga kjo lëmi.

Nga certifikata e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e Kroacisë, e datës 26.01.2009, me nr.534-07-2-2/2-09-4, vërtetohet fakti se këtu paditësja me datë 26.01.2018 ka dhënë provimin special për Kardiologji, sipas vlerësimit nga komisioni provues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kroacisë, me ç'rast ka fituar titullin "Kardiolog"

Nga vërtetimi i lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare e Zagrebit i datës 10.03.2009, vërtetohet fakti se këtu paditësja ka kaluar një vit në Laboratorin për Kardiologji Invazive dhe Ndërhyrëse, si pjesë e trajnimit të saj subspecialistik në Kardiologji në Departamentin e Mjekësisë Kardiovaskulare në Qendrën Spitalore të Universitetit të Zagrebit. Tutje është konstatuar se paditësja gjat kësaj periudhe, në mënyrë të pavarur ka kryer 450 koronografi dhe ka filluar trajnimin e saj në procedurat intervenuese. Tutje është cekur se ka shkruar në mënyrë të pavarur gjetjet dhe rekomandimin e trajnimit për 100 pacientë, ka filluar ndërhyrjen perkutane në 40 pacientë, nën mbikëqjen e një intervencioniste me përvojë dhe në mënyrë të pavarur ka kryer një pjesë të këtyre procedurave. Po ashtu, ka ndjekur rregullisht konferenca kardiologjike, ku janë diskutuar gjetjet dhe mundësitë e trajtimit.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Fakulteti i Mjekësisë në kuadër të Universitetit të Trakyas në Turqi me nr. B.30.2TRK0.20 i datës 20.11.2013, vërtetohet fakti se paditësja ka qenë e angazhuar në Departamentin e Kardiologjisë – Fakultetit i Mjekësisë në kuadër të Universitetit Trakya, gjatë muajit shkurt të vitit 2010. Tutje është cekur se gjatë kësaj periudhe ajo ka funksionuar si bashkëpunëtorë e kardiologjisë në Laboratorin e Kardiologjisë Intervenuese, ku ka punuar për 7 ditë në javë në disa procedura intervenuese të kardiologjisë, duke përfshirë koronografinë, stentet, angioplastikën me balon, implantimin e stimuluesit kardiak të përhershëm dhe ICD, kateterizimin e zembrës në anën e majtë dhe të djathtë, e gjithashtu ka marrë pjesë në konferencat e departamentit, ekzaminimet

ekokardiologjike, Holter EKG dhe procedurat e testimi të ushtrimeve.

Nga abstrakti i zgjeruar nga Universiteti i Zagrebit - Fakulteti i Mjekësisë, vërtetohet fakti se paditësja ka marrë pjesë në kryerjen e disa punimeve shkencore me këto tema: “Korrelacioni i kohës së protrombinës dhe kohës së përsheptuar të klopidoqrelit në trombozën e stentit në pacientët me stentë me ilaçe dhe stentë metalike të zhveshur”, i publikuar me dt.10.10.2016; “Tromboza e stentit midis stentit me ilaçe dhe stentit metalik të zhveshur”, i publikuar me dt.15.08.2013.

Paditësja me datë 14.06.2018, ka parashtruar ankesë, e cila është evidentuar me numër protokollit 6037, duke pretenduar se nuk është përzgjedhur në pozitën në të cilën ka aplikuar, me arsyetim se nuk ka doktoraturë dhe se nuk janë evidentuar punime shkencore të dokumentuara, duke elaboruar tutje se ka aplikuar në konkursin e shpallur nga e paditura si dhe duke pretenduar se që nga viti 2004 është duke aplikuar në Universitetin e Prishtinës, mirëpo vazhdimisht nuk është pranuar. Në këtë mënyrë aludon se është ballafaquar me padrejtësi nga ana e këtij institucioni.

Nga raporti i shqyrtimit të ankesave të kandidatëve për konkursin nr.1/173, të datës 27.04.2018, i përpiluar me datë 28.07.2018, është konstatuar se ankuesja – këtu paditësja RR.K ka paraqitur ankesë për pozitën 50, por në buletin nuk ka të publikuar recension për këtë pozitë. Tutje është cekur se e njejta ka konkuruar edhe në pozitën 13, ku komisioni recencues ka vlerësuar se nuk i plotëson kriteret. Mbi këtë bazë, ankesa është refuzuar si e pa bazuar.

Në raportin e Komisionit Vlerësues për Emërim, Riemërim dhe Avancim të personelit akademik nr.4777/4 i dt.30.05.2018, fillimisht janë cekur disa të dhëna për kandidatën, me ç’rast përveç të dhënave personale, është konstatuar se këtu paditësja mban gradën shkencore “Mr.Sc”, si dhe nuk ka doktoraturë, ndërsa në rubrikat lidhur me publikimet në revista ndërkombëtare shkencore konform nenit 175, 176 dhe 177 të Statutit të UP-së dhe Rregullores Nr.465, nuk janë konstatuar të tilla.

- Korniza ligjore -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur, duke marrë për bazë natyrën e kontestit dhe raportin juridik mes palëve ndërgjyqëse, fillimisht duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si ligj bazik, në frymën e dispozitës së nenit 2 par.1 të këtij ligji, e cila përcakton që: "*Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës*". Dispozita e nenit 8 par.1 e të njejtij ligj përcakton që: "*Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpallë konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës*". Gjykata iu referua edhe Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dispozita nga neni 173 par.1 e këtij Statuti përcakton që: "*Personeli akademik do të emërohet nga rektori sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike*". Në anën tjetër, paragrafet 4 dhe 5 të të njejtës dispozitë përcaktojnë që: "*Procedurat për emërim do të bëhen në mënyrë transparente me shpalljen e konkursit publik për postin. Të gjitha emërimet bëhen pasi t'i shqyrtojnë dokumentacionin e aplikimit komisioni vlerësues i formuar nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e degës – departamentit. Komisioni vlerësues bën vlerësimin e kandidateve të cilët konsiderohen që kanë përmbushur kushtet për postin e ofruar*". Neni 174 i këtij Statuti përcakton: "*Kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës*". Së fundmi, Gjykata iu referua edhe dispozitës

së nenit 175 të këtij Statuti, e cila përcakton kriteret të cilat duhet plotësuar për titullin profesor i rregullt i njësisë akademike, dhe formulohet në këtë mënyrë: *1. Për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike kandidati duhet të ketë këto kualifikime: 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës (ekuivalente më të në Fakultetin e Arteve); 1.2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me: 1.2.1. një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, si autor i pare ose korrespondent; 1.2.2. pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare; 1.2.3. Krijime a punime të njohura artistike ose të ketë pasur prezantime publike dhe të ketë kontribuar kur është rasti i Fakultetit të Arteve; në mënyrë të veçantë duhet të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit; 1.2.4. përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme; 1.2.5 aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme; 1.2.6. aftësi për udhëheqje akademike; 1.2.7. udhëheqje të temave master dhe të doktoratës.*"

- Vlerësimi i Gjykatës -

Fillimisht, duhet përqendruar vëmendjen tek fakti se në kontestet të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, cenimi i të drejtave të pretenduara të cilat burojnë nga kjo materie, mund të vijë në shprehje përmes nxjerrjes së vendimeve apo akteve të ndryshme nga ana e subjektit punëdhënës. Rrjedhimisht, mbrojtja gjyqësore duhet të konsistojë në kërkesën për anulimin e vendimeve të tilla, apo ofrimin e ndonjë kompensimi të arsyeshëm të karakterit monetar, nënkuptohet mbi bazën e pretendimit dhe argumentimit të faktit se është cenuar ndonjë e drejtë. Në rastin konkret, pala paditëse me palën e paditur nuk kanë të themeluar marrëdhënie pune, rrjedhimisht nuk gjenden në raportin juridik punëdhënës – punëmarrës. Megjithatë, standardet e lartëcekura aplikohen në mënyrë të ngjashme edhe në rastet kur synohet të themelohet marrëdhënia e punës, që nënkupton se subjektit i cili pretendon dhe synon të themelojë marrëdhënie pune, mund t'i cenohet ndonjë e drejtë nga ana e subjektit i cili ka shpallur konkurs për themelimin e marrëdhënies së punës. Thënë kjo, paditësja kërkesën kryesore në këtë çështje kontestimore e ka orientuar drejt anulimit të konkursit nr.1/173, të datës 27.04.2018, të shpallur nga këtu e paditura, gjegjësisht detyrimit të të paditurës që të shpallë konkurs të ri në pozitë në të cilat ka aplikuar. Shpallja e konkursit, si akt në vetvete në aspektin procedural nuk është i përfshirë me elemente të kundërligjshme dhe nuk cenon ndonjë të drejtë nga marrëdhënia e punës. Një veprim i tillë për më tepër është në harmoni me dispozitat e lartëcituara nga nenet 8 par.1 të Ligjit të Punës, lidhur me nenin 173 par.4 dhe 5 të Statutit të UP-së. Veprimet dhe aktet të cilat janë derivat i konkursit të shpallur, mund të paraqesin objekt trajtimi në kontekstin e vlerësimit nëse është ndjekur procedura dhe janë respektuar standardet e përcaktuara me dispozitat e akteve normative që e rregullojnë ecurinë e një procedure të tillë. Paditësja përmes ushtrimit të padisë nuk e ka kontestuar ndonjë vendim apo akt i cili është derivat i këtij konkursi, në mënyrë që akti i tillë t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor në aspektin e shqyrtimit të ligjshmërisë dhe vlerësimit të faktit nëse si rezultat i të njejtit janë cenuar të drejtat dhe interesat legjitime të pretenduara të palës paditëse.

Në aspektin e së drejtës materiale, Gjykata vlerëson se Statuti i Universitetit të Prishtinës, paraqet akt të veçantë të aplikueshëm që rregullon në tërësi materien e funksionimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Akti i mësipërm bazën ligjore e ka të mbështetur në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 par.1 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr.04/L-037. Në kuadër të fushëveprimtarisë së këtij akti, bën pjesë edhe çështja e

emërimit të personelit akademik, respektivisht procedurat dhe kriteret për emërim apo avancim për çfarëdo titulli akademik.

Në rastin konkret, paditësja ka aplikuar për pozitën Profesor në lëndët Mjekësia Interne, Propedeutika e Mjekësisë Interne dhe Hyrje në Mjekësi. Kriteret kualifikuese të cilat duhet të përmbushen për tu emëruar në pozitat për të cilat ka aplikuar paditësja janë të përcaktuara me dispozitën nga neni 175 të Statutit të UP-së, e të cilat janë renditur në mënyrë taksative në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi. Kriteret e tilla vlen të theksohet se duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Kriteri i parë, dhe njëherit bazik edhe për nga renditja, e që kërkohet nga një kandidat për të fituar titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike konsiston në posedimin e gradës së doktorit të shkencës. Në rastin konkret, në bazë të provave të cilat janë bashkangjitur në shkresat e lëndës, Gjykatës i rezulton se paditësja me datë 30.06.1998 i ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë - Dega Mjekësi e Përgjithshme, me ç'rast ka marrë kualifikimin "Doktor i Mjekësisë", ndërësa ato pasdiplomike me dt.27.06.2011, me ç'rast ka marrë titullin "Magjistër i Shkencave të Mjekësisë".

Në anën tjetër, Gjykatës nuk i rezulton se paditësja, në momentin kur ka aplikuar në konkursin e kontestuar, respektivisht me dorëzimin e dokumentacionit mbështetës, ka arritur ta provojë faktin se ka fituar titullin e doktorit të shkencës. Një fakt i tillë është eviedntuar edhe në raportin e Komisionit Vlerësues për Emërim, Riemërim dhe Avancim të personelit akademik nr.4777/4 i dt.30.05.2018, ku në rubrikën e të dhënave të kandidatit është konstatuar se kandidatja RR.K nuk ka doktoraturë. Për më tepër, edhe pala paditëse, me rastin e parashtrimit të padisë, ka sqaruar se është në vitin e tretë dhe të fundit të studimeve të doktoraturës, ndërësa gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se në vitin 2011 ka fituar titullin "Magjistër i Shkencave", ndërësa studimet e doktoraturës i ka regjistruar në Zagreb dhe në kohën e shpalljes së konkursit ka qenë kandidate për PhD.

Gjykata trajtoi me vëmendje pretendimet e palës paditëse lidhur me faktin se e njejta ka përvojë të gjatë si mësimdhënëse si dhe ka marrë pjesë në publikimin e punimeve të ndryshme shkencore dhe hulumtuese, të cilat nuk janë trajtuar dhe nuk janë marrë fare parasysh në raportin mbi aktivitetin hulumtues, shkencor dhe profesional të kandidates. Në raport me këto pretendime, Gjykata konstatoi se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës rezulton që përvoja e punës së paditëses, respektivisht pjesëmarrja e të njejtës në konferenca, aktivitete dhe publikimin e punimeve shkencore dhe hulumtuese është e një niveli tejet të respektueshëm. Thënë kjo, kriteret e tilla nuk kanë shërbyer si të vetme në funksion të vlerësimit të faktit nëse paditësja i plotëson kushtet për tu përzgjedhur në pozitat në të cilat ka aplikuar, rrjedhimisht nuk mund ta kenë penalizuar të njejtën për tu përzgjedhur në këtë pozitë. Në prezencën e një kriteri substancial, e që ka të bëjë me posedimin e gradës së doktorit të shkencës, të cilin kriter paditësja është konstatuar se nuk e ka përmbushur, rezulton se standardi i kërkuar për tu provuar e tejkalon atë që pala paditëse ka arritur ta provojë në funksion të mbështetjes së themelësisë së kërkesës së saj. Mbi këtë bazë, gjetjet e Gjykatës konsistojnë në faktin se në këtë çështje juridike nuk është provuar cenimi i të drejtave të paditëses nga marrëdhënia e punës.

Në prezencën e rrethanave të tilla, Gjykata vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, përmes së cilës ka kërkuar që të anulohet konkursi nr.1/173, i datës 27.04.2018 i Fakultetit të Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për pikat 13 dhe 50 të Konkursit, duke përfshirë të gjitha veprimet e

ndërmarra me rastin e pranimit të kandidatit të sukseshëm, si dhe të detyrohet e paditura që brenda afateve të parapara të shpallë konkurs të ri për pozitën e mësimeve në lëndët Mjekësia Interne, Propedeutike e Mjekësisë Interne dhe Hyrje në Mjekësi në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës.

Vendimin që secila nga palët ndërgjyqëse t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyqfituese nuk i ka kërkuar apo specifikuar shpenzimet lidhur me këtë procedurë.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitës nga neni 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil -
C.nr.3926/18, datë 24.04.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.